REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 317, Datë 26.10.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 46 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 3183 prot., datë 26.10.2026 të përgatitur nga Grupi i Punës të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026 "*Mbi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin dhe miratimin e* "*Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 46 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", transferimi i aseteve të të licencuarit që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar i nënshtrohet miratimit paraprak nga ERE, sipas kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë. Gjithashtu, ligji i ngarkon ERE-s përcaktimin, me rregullore, të procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre transferimeve, si dhe të rasteve kur miratimi paraprak nuk kërkohet.
- Me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 137, datë 18.08.2026, është ngritur Grupi i Punës për hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore që lidhen me licencimin dhe ushtrimin e veprimtarive të licencuara në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026; ndër detyrat e tij është edhe hartimi i projekt-rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.
- Rregullorja për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor të mëparshëm. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", është bërë i nevojshëm rishikimi i kësaj rregulloreje, me qëllim përshtatjen e procedurave dhe kritereve për miratimin e transferimit të aseteve, si dhe përcaktimin e rasteve kur miratimi paraprak nga ERE nuk kërkohet, në përputhje me nenin 46 të ligjit.
- Projekt-rregullorja përcakton fushën e zbatimit, rastet kur transferimi i aseteve të të licencuarit kërkon miratimin paraprak nga ERE dhe përjashtimet nga ky detyrim, dokumentacionin që duhet të paraqitet nga aplikuesi, procedurën e verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesës, afatet procedurale, kriteret e vlerësimit dhe vendimmarrjen e Bordit të ERE-s. Nëpërmjet këtyre përcaktimeve synohet të sigurohet një trajtim i njëtrajtshëm dhe transparent i kërkesave, duke vlerësuar ndikimin e transferimit të aseteve në vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar, përmbushjen e kushteve të licencës, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit, si dhe mbrojtjen e interesave të klientëve.

- Përpara miratimit përfundimtar, projekt-rregullorja do t'i nënshtrohet procedurave të konsultimit dhe shqyrtimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe rregullat e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për shqyrtimin dhe miratimin e "*Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike*", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Projekt-rregullorja i nënshtrohet procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.
3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, publikimin dhe konsultimin e projek-rregullores, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe përgatitjen e relacionit përfundimtar dhe të projekt-rregullores të rishikuar për shqyrtim nga bordi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e vendimit brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, në rast se ka siguruar prova të reja që mund të çojnë në marrjen e një vendimi të ndryshëm ose në rast të gabimeve materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s Nr. 317, Datë 26.10.2026

Projekt-RREGULLORE

"PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", i cili parashikon miratimin paraprak nga ERE të transferimit të aseteve të të licencuarit që shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, si dhe përcaktimin me rregullore të rasteve kur miratimi nuk kërkohet.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e ERE-s për transferimin, shitjen, dhënien me qira, hipotekimin, vendosjen e barrëve ose çdo formë tjetër disponimi mbi asetet e të licencuarit, duke garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar, sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e klientëve, transparencën dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes rregullatore.

Neni 3
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për personat e pajisur nga ERE me licencë për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike dhe operimit të pikave të rikarikimit, për aq sa asetet përkatëse përdoren për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

2. Rregullorja zbatohet për transaksionet që, pavarësisht formës juridike, sjellin ose mund të sjellin ndryshim të pronësisë, posedimit, përdorimit, kontrollit ekonomik apo disponueshmërisë së aseteve të lidhura ngushtë me veprimtarinë e licencuar.

3. Kjo rregullore nuk rregullon transferimin e licencës si procedurë më vete, e cila trajtohet edhe sipas akteve të ERE-s për licencimin. Kur transaksioni përfshin njëkohësisht transferimin e aseteve dhe të licencës, kërkesat shqyrtohen në mënyrë të bashkërenduar, pa cenuar plotësimin e kërkesave të secilës procedurë.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Aset” është aktivi afatgjatë material, pajisja, impianti, linja, nënstacioni, infrastruktura ose pasuria tjetër që përdoret drejtpërdrejt ose është e domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

b) “Transferim asetesh” është çdo veprim juridik ose ekonomik që sjell shitjen, kalimin, dhënien me qira, hipotekimin, vendosjen e barrës, dhënien në përdorim ose çdo formë tjetër disponimi mbi asetet e të licencuarit.

c) “Asete të lidhura ngushtë me veprimtarinë e licencuar” janë asetet pa të cilat veprimtaria e licencuar nuk mund të kryhet në mënyrë të sigurt, të vazhdueshme ose në përputhje me kushtet e licencës.

ç) “Asete me vlerë minimale” janë asetet që përmbushin pragjet dhe kushtet e përjashtimit të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

d) “Aplikues” është i licencuari që paraqet kërkesën për miratim paraprak.

dh) “Përfitues” është personi fizik ose juridik që merr ose pritet të marrë pronësinë, përdorimin, të drejtën e sigurisë ose një të drejtë tjetër mbi asetet.

e) “Projekt i ri” është projekti i ri i kapaciteteve të prodhimit ose depozitimit që është në fazë zhvillimi, financimi, ndërtimi ose komisionimi dhe që nuk ka nisur ende ushtrimin e veprimtarisë së licencuar me asetet objekt të transaksionit.

Neni 5
Parimet e shqyrtimit

1. ERE shqyrton kërkesat në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

2. Shqyrtimi synon të verifikojë se transaksioni nuk cenon sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimit, të drejtat e klientëve, kushtet e licencës, integritetin dhe sigurinë e rrjetit, konkurrencën, ndarjen e veprimtarive dhe interesin publik.

3. Kërkesat për dokumentacion dhe informacion duhet të jenë të lidhura me objektin e shqyrtimit dhe në përpjesëtim me natyrën, vlerën dhe ndikimin e transaksionit.

4. Miratimi nga ERE nuk zëvendëson lejet, autorizimet, miratimet kontraktore apo regjistrimet që kërkohen nga legjislacioni tjetër në fuqi.

PJESA II

RASTET E MIRATIMIT DHE PËRJASHTIMET

Neni 6
Detyrimi për miratim paraprak

1. Miratimi paraprak i ERE-s kërkohet për transferimin e aseteve që shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, përveç rasteve të përjashtuara shprehimisht nga kjo rregullore.

2. Kërkesa për miratim paraqitet përpara nënshkrimit të aktit përfundimtar ose, kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së transaksionit, përpara se transaksioni të prodhojë efekte juridike mbi asetet dhe veprimtarinë e licencuar.

3. Palët mund të lidhin marrëveshje paraprake ose me kusht pezullues, me kusht që të parashikohet shprehimisht se realizimi dhe hyrja në fuqi e transferimit, për aq sa kërkohet miratimi i ERE-s, kushtëzohet nga marrja e këtij miratimi.

4. Vendosja e hipotekës ose e një barre mbi asetet nuk përjashtohet automatikisht nga miratimi. Përjashtimet zbatohen vetëm në kushtet e nenit 8 dhe kur krijimi ose ekzekutimi i sigurisë nuk sjell transferim të kontrollit operacional apo disponim mbi asetet që kërkon miratim.

Neni 7
Asetet me vlerë minimale dhe asetet që nuk lidhen ngushtë me veprimtarinë e licencuar

1. Në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 59/2026, miratimi paraprak i ERE-s nuk kërkohet për asetet që plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) vlera e përgjithshme e aseteve objekt të një transaksioni ose të transaksioneve të lidhura është jo më e madhe se 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

b) transferimi nuk cenon aftësinë e të licencuarit për të përmbushur kushtet e licencës;

c) transaksioni nuk sjell ndërprerje ose rrezik të arsyeshëm për ndërprerjen e shërbimit, ulje të sigurisë së furnizimit.

2. Për hidrocentralet me fuqi të instaluar më të vogël se 5 MW, miratimi paraprak kërkohet kur vlera e aseteve që transferohen është më e madhe se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

3. Përjashtimi nuk zbatohet për transaksione të ndara artificialisht me qëllimin ose efektin e shmangies së pragut të miratimit. ERE mund të vlerësojë si një transaksion të vetëm veprime të lidhura sipas palëve, objektit, kohës ose qëllimit ekonomik.

4. Për qëllime të këtij neni, vlera e aseteve provohet me dokumentacion kontabël, vlerësim të pavarur kur është i nevojshëm që justifikon vlerën e transaksionit.

Neni 8
Dokumentimi

I licencuari mban dokumentacionin që provon plotësimin e kushteve të nenit 7 dhe ia vë atë në dispozicion ERE-s me kërkesë për të verifikuar zbatimin e përjashtimit.

PJESA III

KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI

Neni 9
Paraqitja e kërkesës

1. Procedura fillon me paraqitjen në ERE të kërkesës së nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor ose personi i autorizuar/i deleguar. Në këtë rast duhet të paraqitet në ERE prokura ose autorizimi i dhënë nga i licencuari për përfaqësimin e tij.

2. Kërkesa identifikon veprimin juridik të propozuar, asetet objekt të transaksionit, vlerën e tyre, palët e përfshira, afatin e parashikuar të realizimit dhe arsyet që e bëjnë të nevojshëm transferimin.

3. Kur kërkesa lidhet me disa asete ose me disa palë përfituese, aplikuesi paraqet listë të veçantë për çdo aset dhe shpjegon marrëdhënien ndërmjet transaksioneve.

4. Kërkesa dhe dokumentacioni paraqiten në gjuhën shqipe, origjinal, fotokopje e noterizuar ose me vulë elektronike. Dokumentet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së kërkesës. I gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të depozitohet në format elektronik. Dokumentet në gjuhë të huaj shoqërohen me përkthim në shqip, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10
Dokumentacioni i kërkuar

1. Kërkesës i bashkëlidhen, sipas rastit dhe natyrës së transaksionit:

a) ekstrakti historik dhe aktual i regjistrit tregtar për aplikuesin dhe përfituesin, të lëshuar brenda tre muajve para paraqitjes së kërkesës;

b) përshkrimi i veprimtarisë së licencuar që lidhet me asetet;

c) përshkrimi teknik dhe funksional i aseteve, vendndodhja, kapaciteti, gjendja e tyre dhe roli në ushtrimin e veprimtarisë së licencuar;

ç) lista e detajuar e aseteve që transferohen, me identifikuesit/kodet përkatëse në rast disponimi të tyre dhe vlerën e detajuar të secilit aset/përfshirë e totalin e aseteve që kerkohet për transferim;

d) marrëveshja paraprake ose projektmarrëveshja e nënshkruar nga palët, ku të përcaktohen objekti, çmimi ose kundërshpërblimi, afatet, kushtet pezulluese dhe ndarja e përgjegjësive;

dh) informacion në lidhje me arsyen e kërkesës së transferimit, që përfshin arsyetimin ekonomik dhe teknik, përfshirë alternativat e shqyrtuara;

e) pasqyrat financiare të aplikuesit dhe kur është e nevojshme për vlerësimin e aftësisë për operim, të përfituesit, për tre vitet e fundit ose për periudhën e disponueshme nëse subjekti ka më pak se tre vjet nga krijimi;

ë) analiza e ndikimit të transaksionit në gjendjen financiare të aplikuesit, aftësinë për mirëmbajtjen e aseteve, investimet e miratuara dhe përmbushjen e detyrimeve të licencës;

f) deklarata që provon aftësinë teknike, financiare dhe organizative të përfituesit për të administruar ose operuar asetet, kur kjo është e zbatueshme;

g) analiza e ndikimit në sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit, cilësinë e shërbimit, klientët, tarifat, konkurrencën dhe funksionimin e rrjetit;

gj) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror përgjegjës (MIE) për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga aktet e nënshkruara me këtë autoritet, ose informacion mbi statusin e marrjes së tij;

h) lista e transferimeve të ngjashme të kryera nga aplikuesi gjatë tre viteve të fundit, nëse ka;

i) deklaratë e përfituesit për marrjen përsipër të detyrimeve që lidhen me asetet dhe për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, kur është e zbatueshme;

j) prokurë ose dokument që provon kompetencën e personit që nënshkruan kërkesën.

2. Për asetet e një shoqërie koncesionare ose për asetet që lidhen me një marrëveshje zhvillimi me shtetin, aplikuesi paraqet edhe dispozitat kontraktore përkatëse dhe provën e njoftimit ose të miratimit të autoritetit shtetëror, kur kërkohet.

3. ERE mund të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm kur ai është i nevojshëm për shqyrtimin e kritereve të kësaj rregulloreje. Kërkesa për informacion shtesë duhet të tregojë arsyen dhe çështjen që synohet të verifikohet.

4. Dokumentet që përmbajnë informacion të ndjeshëm tregtar identifikohen nga aplikuesi, i cili arsyeton kërkesën për trajtim konfidencial. Trajtimi bëhet në përputhje me ligjin dhe nuk cenon detyrimet e ERE-s për publikim.

PJESA IV

SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 11
Kontrolli paraprak i kërkesës

1. Pas regjistrimit të kërkesës, ERE kryen verifikimin paraprak të saj, me qëllim konstatimin e përputhshmërisë së kërkesës me kërkesat formale dhe dokumentacionin e përcaktuar në këtë rregullore.
2. Verifikimi paraprak përfshin kontrollin e plotësisë së dokumentacionit, identifikimin e aseteve objekt të transferimit, përcaktimin e objektit të kërkesës dhe verifikimin e nënshkrimit të saj nga personi i autorizuar për përfaqësimin e subjektit aplikues.
3. Nëse gjatë verifikimit paraprak konstatohen mangësi në dokumentacionin e paraqitur, ERE vepron sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
4. Përfundimi i verifikimit paraprak dhe administrimi i dokumentacionit nuk përbëjnë miratim të kërkesës për transferimin e aseteve.
5. Kur nga verifikimi paraprak rezulton se subjekti aplikues ka paraqitur, që në fazën e parë të aplikimit, të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga kjo rregullore, ERE vijon drejtpërdrejt me shqyrtimin në themel të kërkesës, pa qenë e nevojshme marrja e një vendimi të veçantë për fillimin e procedurave të shqyrtimit. Në këtë rast, afati për marrjen e vendimit nga Bordi i ERE-s llogaritet nga data e regjistrimit të kërkesës në ERE, në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 12
Vlerësimi rregullator

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ERE vlerëson, në masën që lidhet me transaksionin:

a) nëse asetet janë të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar dhe nëse transferimi ndikon në përmbushjen e kushteve të licencës;

b) ndikimin në sigurinë, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit, si dhe në interesat e klientëve;

c) ndikimin në tarifat e rregulluara, kostot e rrjetit dhe mundësinë e kalimit të kostove te klientët;

ç) aftësinë financiare, teknike dhe organizative të aplikuesit pas transaksionit dhe, kur është e zbatueshme, të përfituesit;

d) ndikimin në realizimin e investimeve të miratuara, mirëmbajtjen e aseteve dhe përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik;

dh) ndikimin në konkurrencë, aksesin në rrjet dhe respektimin e kërkesave të ndarjes së veprimtarive, kur këto çështje janë të zbatueshme;

e) nëse transaksioni cenon detyrimet e përcaktuara në licencë, kodet e rrjetit, rregullat e tregut ose aktet e tjera të ERE-s;

ë) nëse janë marrë ose duhet të merren miratime nga autoritete të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

2. ERE mund të kërkojë sqarime, të verifikojë të dhënat në dokumentet e paraqitura dhe, kur është e nevojshme e proporcionale, të kryejë verifikim në vend.

3. Kur transaksioni prek asetet e operatorit të transmetimit ose shpërndarjes, ERE vlerëson ruajtjen e funksionimit të sigurt dhe të pavarur të rrjetit, si dhe shmangien e diskriminimit dhe ndërsubvencionimit.

4. ERE mund të marrë në shqyrtim mendimet e institucioneve ose autoriteteve kompetente, kur kjo kërkohet nga ligji ose është e nevojshme për shqyrtimin e çështjes.

Neni 13
Afati i shqyrtimit

1. ERE shqyrton kërkesën dhe merr vendim brenda 45 ditëve pune nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.

2. Në rast se, gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës, ERE konstaton se dokumentacioni i paraqitur është i paplotë ose se nevojiten të dhëna dhe dokumente shtesë, njofton me shkrim subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe kërkon plotësimin e tyre brenda 10 ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës në ERE. Njoftimi i dërgohet subjektit aplikues brenda 10 ditëve pune nga data e regjistrimit të kërkesës. Subjekti aplikues plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit brenda këtij afati, ERE vijon shqyrtimin mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe, kur mungesat e konstatuara nuk lejojnë vlerësimin e kërkesës, vendos për refuzimin e saj me vendim të arsyetuar.

Neni 14
Vendimi i Bordit

1. Në përfundim të shqyrtimit, Bordi i ERE-s vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës.

2. Vendimi për miratim mund të përmbajë kushte të arsyetuara, të nevojshme dhe proporcionale për të garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar, sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e klientëve dhe respektimin e detyrimeve rregullatore.

3. Kërkesa refuzohet kur, bazuar në dokumentacionin dhe vlerësimin e kryer, transaksioni cenon objektivat e ligjit nr. 59/2026, rrezikon përmbushjen e kushteve të licencës, krijon rrezik të papranueshëm për shërbimin ose kur aplikuesi nuk provon plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

4. Vendimi shoqërohet me relacion argumentues dhe përmban arsyet kryesore të pranimit ose refuzimit, kushtet e vendosura, si dhe mënyrën dhe afatin e ankimit.

Neni 15
Njoftimi, publikimi dhe konfidencialiteti

1. Vendimi i Bordit i njoftohet aplikuesit dhe, kur është e zbatueshme, përfituesit dhe autoritetit shtetëror përgjegjës, brenda afatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Vendimet publikohen në përputhje me ligjin nr. 59/2026, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e publikimit të akteve të ERE-s.

3. Informacioni i ndjeshëm tregtar trajtohet në mënyrë konfidenciale në masën e lejuar nga legjislacioni. Konfidencialiteti nuk mund të përdoret për të penguar publikimin e vendimit, arsyetimit rregullator ose informacionit që ligji kërkon të bëhet publik.

Neni 16
Realizimi i transferimit dhe detyrimet pas miratimit

1. I licencuari nuk mund të realizojë transaksionin përpara marrjes së miratimit paraprak, në rastet kur ky miratim kërkohet.

2. Pas realizimit të transferimit, i licencuari i paraqet ERE-s, brenda 30 ditëve kalendarike, dokumentacionin që provon realizimin e transaksionit dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e miratimit, përveçse kur vendimi përcakton një afat tjetër.

3. I licencuari mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të licencës deri në momentin kur, sipas ligjit dhe vendimeve përkatëse të ERE-s, këto detyrime ndryshohen ose kalojnë ligjërisht te një subjekt tjetër.

4. Nëse transaksioni nuk realizohet brenda afatit të përcaktuar në vendim ose ndryshojnë kushtet thelbësore të tij, aplikuesi njofton ERE-n. ERE vlerëson nëse kërkohet kërkesë e re ose ndryshim i vendimit.

5. Mosrespektimi i vendimit të ERE-s ose realizimi i transferimit pa miratimin e kërkuar trajtohet sipas masave dhe procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 17
Rishikimi dhe ankimi

1. Rishikimi i vendimit të Bordit për gabime materiale ose prova të reja bëhet sipas nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 dhe dispozitave të tjera të zbatueshme.

2. Kundër vendimit të Bordit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 59/2026.

3. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji ose kur gjykata vendos pezullimin.

PJESA V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Dispozita kalimtare

1. Kërkesat për transferim asetesh të paraqitura dhe ende të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shqyrtohen sipas legjislacionit të zbatueshëm, duke marrë parasysh dispozitat kalimtare të ligjit nr. 59/2026 dhe parimin e sigurisë juridike.

Neni 19
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, si dhe çdo dispozitë e akteve të ERE-s që bie në kundërshtim me këtë rregullore, për aq sa lidhet me sektorin e energjisë elektrike.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s për miratimin e saj dhe publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.